

**STATUT I SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“Midea Solution” Sh.P.K**

**EMERI I SHOQERISE,SELIA,OBJEKTI,KOHEZGJATJA**

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, vendosëm hartimin e këtij Statuti , me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

**KREU I**

**Neni 1**

Shoqëria “*Midea Solution*” Sh.P.K, është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne Organet Kompetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “*Midea Solution*” Sh.P.K, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga z. *Marsel Gjeka*, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakeve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortaket gëzojnë kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kane dhënë në kapital.

**Neni 3**

**Selia**

*Shoqëria Tregtare “Midea Solution” Sh.P.K e ka selinë me adrese :Lagjia Pavaresia,Rruga Dush Strati,Ish Ekspozita-Godine private Kati i pare,Nr 2,Vlore.*

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

**Neni 4**

**Objekti i veprimtarise**

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj: Import-eksport: Tregeti me shumice dhe pakice te detergjenteve, artikujve ushqimor dhe industrial, aksesori inoxi dhe plastike. Tregeti te artikujve te ndryshem te bute per perdorim spitalor, hoteleri, restorante dhe ente publike etj te ngjashem si dhe lenden e pare per prodhimin e tyre. Tregeti te nje game te gjere te produkteve te pastrimit.

**Neni 5**  
**Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore pa afat.

**KREU II**  
**KAPITALI**

**Neni 6**

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga kontributi i ortakeve themelues me vleren 100.000 (njëqind mijë) lekë dhe perbehet teresisht nga kapitali në para.

Kapitali themeltar ndahet ne 1 kuot me vlere nominale te barabarte prej 100 000 (njëqindmijë) lekë. Nje kuote pervec vleres nominale te saj, ka edhe vleren e nje vote ne mbledhjen e asamblese se ortakeve.

Ne momentin e krijimit te shoqerise, Kapitali themeltar prej 100.000 (njëqind mije) leke eshte paguar teresisht nga ortakët themelues. Ne baze te kontributit te paguar pjesmarrja e ortakeve ne kapitalin themeltare eshte *Marsel Gjeka* me 100 % te kontributit.

**Neni 7**

**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë. Zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakeve te Shoqerise në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

**Neni 8**

**Kuotat**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombetare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Transferimi i kuotave të tretet kufizohet me miratim të asamblese se ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

## **KREU II**

### **ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMMARRESE**

#### **Neni 9**

##### **Organi Vendimmarres**

“Ortaket e shoqërisë” perbejne organin e vetem vendimmarres te shoqërisë.

Ortaket e shoqërisë” perbejne organin e vetem vendimmarres te shoqërisë, qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqërisë.

*Ortaket e shoqërisë, vendosin për çështje si:*

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortakët e shoqërisë regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### **Neni 10**

##### **Administrimi**

*Administrator i shoqërisë caktohet z Marsel Gjeka, i biri i Mihallaqit, i lindur më 23.06.1988 ne Kuçove dhe banues ne Vlore , posedues i kartës së identitetit me numër nr.personal ID : I80623109U*

*Administratori emerohet me afat 5 vjecar, prej 18.06.2024 deri 17.06.2029 dhe shkarkohet me vendim te Ortakeve te shoqerise.*

#### **Neni 11**

##### **Kompetencat**

Administratori ushtron kompetenca ne emer te Shoqerise:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) te përgatise dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për

shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

- e) te krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) te kryejë regjistrimet dhe dërgoje të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) te raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrase mbledhjen e ortakeve të shoqërisë dhe në rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë pasuri, që ka vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
- c) Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.
- d) Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

## **Neni 12**

### **Përgjegjësia**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; jep kredi.

### **Neni 13**

#### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

#### **Neni 14**

##### **Bilanci i shoqerise dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### **Neni 15**

##### **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### **Neni 16**

Të ardhurat neto ( Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, mbeten dhe kalojne ne pronesi, ortakeve të shoqerise.

#### **Neni 17**

*Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :*

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve te shoqerise;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket e shoqerise marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tyre emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë

falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket e shoqërisë. Nëse Ortaket e shoqërisë nuk marrin vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 18**

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

#### **Neni 19**

##### **Të drejtat e detyrimet e likuiduesit**

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave.

Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

#### **Neni 20**

### **Përfundimi i likuidimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

#### **Neni 21**

##### **Bashkimi**

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

#### **Neni 22**

##### **Ndarja**

Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakeve të shoqërisë, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

- a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta
- b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

### **Neni 23**

#### **Shndërrimi**

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

### **Neni 24**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 25**

#### **Mosmarreveshjet**

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

### **Neni 26**

#### **Dispozita përfundimtare**

Ky Statut u redaktua në 4 ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë nga ortakët themelues të shoqërisë.

**ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË “Midea Solution” Sh.P.K**

Vlore më 18/06/2024

/ *Marsel Gjeka* /

*Marsel Gjeka*  
*Marsel*  
*24*